LIGJ
Nr.8370, datë 9.7.1998

PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet veprimtaria e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Organet që përbëjnë shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë janë Ministria e Punëve të Jashtme, përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, si dhe përfaqësitë e tjera të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit.

Neni 3

Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit lokal, për ushtrimin e veprimtarive të tyre që kanë të bëjnë me bashkëpunimin me jashtë, të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë me Ministrinë e Punëve te Jashtme.

FUNKSIONI I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE I PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE E KONSULLORE

Neni 4

Ministria e Punëve të Jashtme është organ i administratës shtetërore i specializuar për marrëdhëniet me jashtë që përpunon, organizon dhe zbaton veprimtarinë e shtetit shqiptar në fushën e politikës së jashtme në marrëdhëniet me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare.

Ajo ka për qëllim.

a) të shprehë e të mbrojë interesat e shtetit shqiptar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare;

b) të koordinojë dhe të drejtojë marrëdhëniet me jashtë. Ministria e Punëve të Jashtme përfaqëson Republikën e Shqipërisë në mbledhjet e ndryshme dypalëshe dhe shumëpalëshe, kryen bisedime në emër të Presidentit të Republikës e të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ndërhyn pranë qeverive të shteteve të huaja. Koordinon veprimtarinë me jashtë të dikastereve dhe institucioneve shtetërore në qendër dhe në bazë;

c) të informojë Kuvendin Popullor, Presidentin e Republikës dhe Kryetarin e Këshillit të Ministrave për zhvillimet ndërkombëtare politike, ekonomike e sociale, si dhe për gjendjen në vende të ndryshme;

ç) të mbrojë interesat e shtetasve shqiptarë që janë të vendosur jashtë dhe t'i ndihmojnë

ata;

d) të zbatojë politikën e shtetit shqiptar lidhur me bashkëkombësit tanë kudo ku ata ndodhen.

Neni 5

Përfaqësitë diplomatike mbulojnë marrëdhëniet e vendit tonë me shtetet ose organizatat ku janë akredituar. Ato ndjekin të gjitha zhvillimet në shtetin, shtetet ose organizatat ku kryejnë funksionet, si në fushën politike, ekonomike, social-kulturore etj.

Çelja dhe mbyllja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Përfaqesia diplomatike drejtohet nga shefi i misionit. Ai perfaqeson ne vendin, vendet ose organizatat ku ushtron funksionin e tij Presidentin e Republikes, Qeverine ne teresi dhe secilin prej ministrave të saj. Ai ka autoritet mbi të gjitha sherbimet civile dhe ushtarake që ushtrojne veprimtarine ne përfaqesine diplomatike të Republikes së Shqipërisë. Ai drejton, udhëzon e kontrollon gjithe veprimtarine zyrtare të personelit të perfaqesise diplomatike.

Shefi misionit varet nga Ministri i Puneve të Jashtme, prej të cilit merr udhezime. Kerkesat dhe udhezimet nga drejtuesit e dikastereve, institucioneve dhe organeve të pushtetit lokal ai i merr vetem nepermjet Ministrit të Puneve të Jashtme.

Neni 7

Funksionet e përfaqesise diplomatike jane:

a) Perfaqëson Republiken e Shqiperise ne shtetin prites.

b) Mbron ne shtetin prites interesat e Republikes së Shqiperise, të shtetasve të saj dhe te personave juridikë të regjistruar ne Republiken e Shqiperise.

c) Zhvillon raporte miqesore dhe bashkepunimi ndermjet Republikes së Shqipërisë dhe shtetit prites ne fushen politiko-diplomatike, konsullore, kulturore-shkencore dhe ne fusha të tjera.

ç) Informon Ministrine e Punëve të Jashtme për gjendjen ekonomike, politike dhe sociale të shtetit prites.

d) Eshte subjekt i bisedimeve ne takimet dy paleshe dhe shumepaleshe, si dhe të marre pjese ne negocimet e marreveshjeve dypaleshe dhe shumepaleshe.

dh) Ndjek zbatimin e marreveshjeve dypalëshe e shumepaleshe.

DREJTIMI I SHERBIMIT TE JASHTEM

Neni 8

Drejtimi ne shërbimin e jashtem ne Ministrine e Puneve të Jashtme kryhet nga ministri i Puneve të Jashtme, sekretari i Shtetit ne Ministrine e Puneve të Jashtme, zëvendesministri i Punëve të Jashtme dhe sekretari i pergjithshëm i Ministrise së Puneve të Jashtme.

ADMINISTRATA QENDRORE

Neni 9

Struktura dhe funksionet e veçanta të administratës qendrore të shërbimit të jashtëm

përcaktohen me akte nenligjore.

KUSHTET PER TE HYRE NE SHERBIMIN E JASHTEM

Neni 10

Përveç kushteve që permenden ne ligjin për sherbimin civil, personi që deshiron të hyje ne sherbimin e jashtëm, duhet:

a) të ketë, ai ose ajo dhe bashkëshortet, shtetesi shqiptare dhe banim të përhershem ne Republiken e Shqiperise. Perjashtime behen vetëm për bashkëshortin (bashkëshorten) ne raste të vecanta me miratim të Ministrit të Punëve të Jashtme;

b) të. ketë perfunduar studimet e larta ne nje institucion arsimor, brenda ose jashte vendit, të njohur nga shteti;

c) të njohe te pakten nje prej gjuheve të huaja , anglisht ose frengjisht;

ç) te ketë aftesi normale fizike dhe psikike.

PRANIMI NE SHERBIMIN E JASHTEM

Neni 11

Për ministrin, sekretarin e shtetit, zëvendësministrin dhe shefat e misioneve që nuk vijne nga karriera diplomatike, hyrja ne sherbimin e jashtem behet me emërimin e tyre ne keto poste.

Neni 12

Pranimi ne shërbimin e jashtem bëhet me konkurs, i cili zhvillohet ne përputhje me normat e percaktuara ne ligjin për sherbimin civil.

Ne raste tepër të vecanta mund të behen edhe emerime pa konkurs (për shkak te cilesive te vecanta të personit, specializimit, personalitetit, reputacionit të vecante që mund të gëzojë ne një vend të caktuar). Ne kete rast personi mund të pranohet ne sherbimin jashtëm pasi Ministri i Punëve të Jashtme të kete marre miratimin nga komisioni i shërbimit civil për kandidaturen konkrete. Propozimin ia ben ministrit të Puneve të Jashtme Keshilli emerues i Ministrisë së Jashtme.

Neni 13

Personi që fiton konkursin, konsiderohet se ben pjese ne sherbimin e jashtem të Republikes së Shqiperise. Që nga ky çast ai nuk mund të beje pjese ne asnjë parti a shoqate politike. Nuk mund të ushtroje asnje veprimtari ne dem apo interes të njeres a tjetres parti ose shoqatë politike.

Dhenia e gradave për personin që ka fituar konkursin, behet vetem pasi të kete kaluar nje vit prove.

Anetari i sherbimit të jashtëm eshte ne raport vartesie me Ministrine e Punëve të Jashtme dhe vepron për zbatimin e politikes së jashtme të percaktuar të shtetit shqiptar. Qendrimi i tij nuk duhet të bjere ne konflikt me angazhimet zyrtare dhe me detyrat që ka marre persiper.

GRADAT DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE, MENYRA E DHENIES SE TYRE

Neni 14

Anëtari i shërbimit të jashtëm mund të gëzojë grada diplomatike dhe konsullore.

a) Gradat diplomatike jane:

Ambasador
Minister fuqiplote
Minister Keshilltar
Këshilltar
Sekretar i parë
Sekretar i dyte
Sekretar i trete
Atashe
b) Gradat konsullore jane:
Konsull i pergjithshem
Konsull
Zevendëskonsull
Agjent konsullor

Kalimi nga nje grade diplomatike ne një grade konsullore dhe anasjelltas bëhet duke respektuar ekuivalencen e gradave, vjetersine ne pune ose duke u mbështetur ne rezultatet e konkurseve për grada . Ekuivalencat jane:

Konsull i pergjithshem	Këshilltar
Konsull	Sekretar i pare ose i dytë
Agjent konsullor	Sekretar i trete ose atashe

Neni 15

Gradat ambasador, ministër fuqiplotë dbe minister këshilltar jepen me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, kurse grada konsull i përgjithshëm jepet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave.

Gradat e tjera diplomatike jepen nga komisioni i gradave, ne përbërje të të cilit jane anëtarët e Këshillit emërues, sekretari i pergjithshëm dhe një ambasador i karrieres.

Neni 16

Punonjesit e sherbimit të jashtem sipas sistemit të karrieres gradohen duke i ngjitur shkallet një nga një. Elemetet kryesore ne dhenien e nje grade për anëtarin e shërbimit të jashtem jane stazhi i shërbimit, aftësitë profesionale dhe rezultatet e punes. Për keto cilësi gjykohet mbi bazen e të dhenave që ndodhen ne dosjen vetjake të çdo punonjesi, sipas menyrave dhe procedurave të përcaktuara me ligj.

Neni 17

Marrja e gradave atashe dhe sekretar i pare behet me konkurs kurse e gradave të tjera behet sipas sitemit të karrieres.

Stazhi minimal për kalimin nga një grade ne një tjeter me të lartë eshte:

- nga atashe ne sekretar të tretë 2 vjet;
- nga sekretar i tretë ne sekretar të dytë 3 vjet;
- nga sekretar i dytë ne sekretar i pare 3 vjet;
- nga sekretar i pare ne këshilltar 4 vjet.

Qe nëpunesi të marrë një grade me të larte, nuk mjafton të ketë plotesuar kushtet për stazhin minimal, aftesitë profesionale dhe rezultatet ne punë, por duhet që edhe ne strukturat e shërbimit të jashtem të jetë një vend vakant që i përgjigjet grades ne fjale

Neni 18

Afati i qendrimit me sherbim jashtë shtetit, ne të njëjtin shtet, për anëtaret e shërbimit të jashtëm eshtë nga 2 deri ne 4 vjet.

Neni 19

Ambasadore ose ministra fuqiplote mund të emërohen edhe persona jashtë sherbimit diplomatik të karrieres, si anëtare ose ish anëtare qeverie, deputetë, personalitete politike, të fushës së kultures, gazetarise etj. Numri i personave që emërohen ne keto poste nuk duhet të jetë me i lartë se 20% e numrit të anëtareve të sherbimit të jashtem, të cilet jane caktuar të punojne jashtë vendit me të njëjten grade. Ambasadoret dhe ministrat fuqiplotë të kësaj kategorie bëjne pjese ne sherbimin e jashtëm për aq kohë sa do t'i ushtrojne keto funksione.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ANETARIT TE SHERBIMIT TE JASHTEM

Neni 20

Anëtari i sherbimit të jashtëm ka të drejte:

a) të mbaje titullin e anëtarit të sherbimit të jashtem të Republikës së Shqipërise;

b) të mbaje funksione ne Ministrine e Puneve të Jashtme, ne përfaqesitë diplomatike, ne misionet e përhershme prane organizatave nderkombetare ne përputhje me përgatitjen dhe kapacitetin e tij profesional, graden, vjetërsine dhe përvojen e fituar;

c) ne periudhen që do të ndodhet me sherbim jashtë shtetit, të përfitoje nga imunitetet dhe privilegjet që ofrojne traktatet dhe konventat ndërkombetare, ne të cilat Republika e Shqipërisë eshtë pale;

ç) personi me grade ambasador, kur punon ne administraten qendrore, emërohet përgjithësisht ne një funksion jo me të ulet se drejtor drejtorie.

Personi me grade ambasador, i cili ka ushtruar funksionin ne ketë grade për një periudhe kohe jo me pak se 10 vjet dhe ka vjetersi pune jo me pak se 25 vjet , kur nuk është titullar i një posti jashtë shtetit ose ne administration qendrore, për një periudhe të caktuar kohe mund të mbahet me cilesine e këshilltarit diplomatik të Qeverise ose ne dispozicion të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Personi me gradën minister këshilltar emërohet ne administraten qendrore përgjithesisht zevendesdrejtor drejtorie ose ne një rang të njëjtë me te.

Sekretari i pare ne administraten qendrore emërohet përgjithesisht shef sektori ose zevendesshef sektori;

Funksionet e tjera diplomatike emërohen specialiste ne administraten qendrore.

d) të mbaje pasaportë diplomatike.

Neni 21

Anëtari i sherbimit të jashtëm dhe shefat e misioneve kane për detyre:

a) të punojne me ndershmeri dhe korrektese për zbatimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërise;

b) të mbrojne interesat e shtetit ose shtetasve shqiptare ne vendin a vendet ku kryejne funksionet;

c) të respektojne ligjet e shtetit shqiptar, të ruajne sekretin shtetëror dhe te sigurojne ruajtjen e të dhenave dhe të informatave që ju besohen;

ë) të mos bëjne pjese ne asnjë parti, organizatë a shoqatë politike; ata nuk duhet të ushtrojne asnjë veprimtari ne dem a ne interes të njeres ose tjetres parti, organizatë apo shoqatë politike; përjashtim bejne titullaret e Ministrise së Puneve të Jashtme, të cilet ruajne statusin politik;

d) të mbajne ne të gjitha rrethanat një qendrim të denjë dhe moral të paqortueshëm;

dh) të mos bejne deklarata që mund të vëne ne pozitë të veshtire shtetin ne marredhnie me shtetet e tjera ose organizata nderkombetare dhe që mund të krijojne probleme ne realizimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë;

c) të respektojne ligjet e shtetit apo shteteve ku jane akredituar dhe të mos implikohen ne veprimtari që mund të konsiderohen si nderhyrje ne punet e brendshme të shtetit ose shteteve ku zhvillojne veprimtarine;

ë) të mos abuzojne me imunitetet dhe privilegjet që gezojee si anëtar të trupit diplomatik;

f) të mos ushtrojne ne shtetin ose shtetet ku jane akredituar veprimtari tregtare ose çdo veprimtari tjeter fitimprurese.

HUMBJA E ANETARESISE DHE HEQJA E GRADES NE SHERBIMIN E JASHTEM TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Neni 22

Humbja e anëtaresisë ne shërbimin e jashtem të Republikës së Shqipërise behet kur personi heq dore ne menyre vullnetare nga ky sherbim, për shkak te plotesimit të moshes së pensionit, për shkaqe natyrore (vdekje), kur kryen vepra penale ose shkel detyrimet që burojne neni 21 i ketij ligji.

Anëtari i shërbimit të jashtëm konsiderohet se ka hequr dore vullnetarisht nga anëtaresia ne sherbimin e jashtem, kur zgjidhet President i Republikës, deputet ne Kuvendiii Popullor ose ne organet e larta shteterore me karkater elektiv. Përjashtim bëjne ministri i Puneve të Jashtme, sekretari i Shtetit ne Ministrine e Punëve të Jashtme dhe zëvendësministri i Puneve te Jashtme.

Për ambasadorët dhe ministrat fuqiplotë heqja e grades behet me dekret të Presidentit te Republikes, kurse për gradat me të uleta heqja e grades behet me urdhër të Ministrit të Puneve të Jashtme, me propozimin e komisionit të gradave.

TRAJTIMI FINANCIAR I PUNONJESVE TË SHERBIMIT TE JASHTEM

Neni 23

Pagat e anëtarëve te sherbimit të jashtem caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pagat caktohen mbi bazen e gradave dhe të funksionit që kryhet ne administration qendrore.

Anëtaret e shërbimit të jashtem. të cilet e ushtrojne veprimtarine e tyre ne përfaqesitë diplomatike ose ne organizatat nderkombetare, për kohën që jane jashtë shtetit, shpërblehen me alokacion ne valute, ku perveç grades diplomatike merret parasysh edhe niveli i jeteses dhe kushtet klimatike ku ai e ushtron veprimtarine.

Neni 24

Koha e shërbimit jashtë shtetit i njihet për etekte të vjetersise ne punë edhe bashkëshortit a bashkeshortes, e cila/i cili shoqeron jashtë shtetit bashkëshortin apo bashkëshorten.

DISPOZITAT TRANZITORE DHE TE FUNDIT

Neni 25

Gjithe anëtaret e sherbimit të jashtem, të cilet ne kohen e daljes së ketij ligji ndodhen me sherbim jashtë vendit, do të mbajne funksionet që kane ne baze të gradave qe jane emëruar deri ne një riemërim të ri.

Në marrjen e gradave ne emërimin e ri ata i nenshtrohen kritereve të përcaktuara nga ky ligj.

Neni 26

Për anëtaret e sherbimit të jashtem, të cilët ne kohën e daljes së ketij ligji punojne ne administraten qendrore, gradat do të jepen mbi bazen e vleresimit të komisionit të gradave dhe të respektimit të afatit të sherbimit si vijon:

- nga atashe ne sekretar të tretë 1 vit;
- nga sekretar i tretë ne sekretar të dytë 1 vit;
- nga sekretar i dytë ne sekretar të parë 2 vjet;
- nga sekretar i pare ne këshilltar 2 vjet.

Neni 27

Neni 26 i ketij ligji ka efekt të përkohshëm, deri ne dhënien e gradave të të gjithe personave që punojne ne administration qendrore (ne Ministrine e Puneve të Jashtme) diten e hyrjes ne fuqi të ketij ligji.

Neni 28

Ky ligj nuk ka efekt prapaveprues.

Neni 29

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerre aktet nenligjore përkatëse ne baze dhe për zbatim të ketij ligji.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2160, datë, 21.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani